



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 20.2.1-2012-08

RAPORTI FINAL I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS SË PRESIDENTIT TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtinë, Maj 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Zyrës së Presidentit të Republikës Kosovës në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti mbështetur nga Mujë Gashi (Udhëheqës i ekipit) dhe Arian Haxhaj.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare.....	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	11
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	13
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	23
6 Konkluzioni i përgjithshëm	25
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP	26
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	28

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave financiare vjetore (PVF-të) për vitin 2012 për Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës (ZPRK). Unë do të doja të falënderoja ZPRK- në për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2012 ishte ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë fokusohet në:

- Pasqyrat Financiare Vjetore (PVF);
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit); dhe
- Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij në formatin e përcaktuar në nen kapitullin 2.3 - Opinioni i Auditimit. Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e ZAP. Raporti i AP-së përfshin një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e pasqyrave financiare.

Opinionin e AP-së është:

Pasqyrat vjetore financiare në të gjitha aspektet materiale paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë*.

Si *Theksim i çështjes*, ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin që informacionet e shpalosura në PVF në lidhje me vlerën e pasurive janë të pasakta dhe jo të plota. Kjo nuk ka ndikim në ndonjërin prej 2 Pasqyrave vjetore financiare (Pranimet dhe Pagesat e Parasë së Gatshme dhe Krahasimin e Buxhetit dhe Shumat Aktuale), sipas SNISA (SNISA 400 *Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes*).

Konkluzioni i përgjithshëm

Niveli i punës së ndërmarrë nga ana e ZAP për të përfunduar auditimin e vitit 2012 është pasqyrim i drejtpërdrejtë i cilësisë së mjedisit të kontrollit të brendshëm të implementuar nga menaxhmenti. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Ne ishim në gjendje të kemi siguri në funksionimin efektiv të kontrolleve menaxheriale në një numër fushash të llogarive. Megjithatë, testimet e kryera kanë identifikuar dobësi në disa fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar siç janë: menaxhimi i prokurimit, menaxhimi në sektorin e pagesave dhe në menaxhimin e pasurisë. Dobësitë janë të shpjguara më në detaje më poshtë.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim të mbështesin ZPRK-ne në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe rritjen e aspekteve tjera të aktivitetit operacional. Ne kemi konsideruar përgjigjet ndaj rekomandimeve tona të bëra në vitin 2011 - pozita aktuale është përmbledhur në Shtojcën II. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se adresimi i vetëm dy (2) nga shtatë (7) rekomandimet e dhëna tregon faktin që ZPRK duhet t'i rishikoj masat e përcaktuara fillimisht dhe t'i identifikoj arsyet për mos zbatimin e tyre.

Kemi diskutuar cilësinë e raportimit financiar të ZPRK-së dhe të gjeturat e tona të detajuara të auditimit në lidhje me Pasqyrat Vjetore Financiare, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Llogaridhënien e Menaxhmentit si dhe Auditimin e Brendshëm në pjesën kryesore të këtij raporti.

Rekomandimet tona kryesore janë si në vijim:

Pasqyrat vjetore financiare

- Të siguroj që gjatë përpilimit të llogarive për vitin 2013, pasuritë e ZPRK-së janë prezentuar dhe shpalosur në PVF sipas vlerës së tyre neto.

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

- Të rishikoj planin e veprimit për të siguruar që stafi llogaridhënës ka kuptuar përgjegjësit dhe detyrat e deleguara si dhe afatet kohore të përcaktuara në atë plan. Më tutje, ZPRK duhet të identifikojë çështjet të cilat janë të një rëndësie të madhe me theks të veçant ato me mangësi sistematike;
- Të përgatit buxhetin për vitin 2013, duke u bazuar në një vlerësim të qëndrueshëm të nevojave, në mënyrë që shfrytëzimi i buxhetit të jetë në pajtim me planifikimet e bëra;
- Të përgatit planin e prokurimit, duke pasur parasysh buxhetin e aprovuar për vitin përkatës. Më tutje, të evitohet ndarjen e kërkesave të prokurimit që janë kryesisht të njëjta ose të ndërlidhura dhe të mbledhë kërkesat, kur është e

mundshme, për të fituar vlerën për paranë dhe për të reduktuar kostot e prokurimit;

- Të siguroj që ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë ligjore të përcaktuara në LMFP, për procesimin e shpenzimeve nga kategorit ekonomike adekuate. Më tutje, të klasifikoj dhe regjistroj shpenzimet në përputhje me kodet ekonomike të parapara me planin kontabël;
- Të shtoj kontrollet në sektorin e pagesave, për të siguruar që avanset janë mbyllur brenda afatit të përcaktuar me ligj; dhe
- Të siguroj që zyrtari i caktuar i pasurisë ka njohuritë e mjaftueshme për menaxhimin e pasurisë dhe të siguroj trajnime të mjaftueshme për këtë zyrtarë.

Sistemi i auditimit të brendshëm

- NJAB gjatë auditimit të fokusohet më shumë në operacionet dhe proceset e vitit aktual, ku menaxhmenti mund të informohet më në hollësi për aktivitetet që janë në proces dhe të ndërmer masa për përmirësim.

Menaxhmenti i ZPRK-së është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do t'i adresojnë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e ZPRK-së të përgatis pasqyrat financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për ZPRK-në. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testimeve të përgjithshme e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2011 mund të gjendet në Shtojcën II.

Ne kemi përfshirë të gjeturat e rëndësishme dhe të tjera më pak të rëndësishme, që dalin nga auditimi ynë. Për plotësinë ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të 9 mujorit aty ku ishte relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të rëndësishme - Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhmenti i lartë e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

Të tjera - Dobësitë e identifikuar në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i pasqyrave vjetore financiare merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e pasqyrave vjetore financiare përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave vjetore financiare. Një numër i pikëve në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Konkluzioni i përgjithshëm

PVF ishin përgaditur në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. ZPRK ka përdorur formatin standard për raportim, dhe ka plotësuar të gjitha kërkesat në pajtueshmëri me kornizën për raportim, në përjashtim të shpalosjeve lidhur me pasuritë kapitale dhe jo kapitale.

Përshkrimi

Pasqyrat vjetore duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi vërejtur se:

- PVF janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave (MF);
- PVF janë nënshkruar nga ZKA dhe ZKF;
- PVF janë pranuar në gjuhën shqipe dhe serbe; dhe
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura gjatë auditimit të 9 mujorit në lidhje me kornizën raportuese në memon tonë të datës 13/12/2012 janë adresuar nga Menaxhmenti.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

Konkluzioni i përgjithshëm

Gjate auditimit ne kemi testuar saktësin dhe plotësinë e informatave të prezentuara në PVF. Si rezultat i auditimit të kryer ne kemi konstatuar se informatat në lidhje me prezentimin dhe shpalosjen e pasurive të ZPRK-së në PVF nuk ishin të sakta.

Përshkrimi

Ky seksion përmban detaje për saktësin dhe plotësinë për pasqyrat financiare gjatë rrjedhës së auditimit, si dhe gjetjet që lidhen me prodhimin e PVF-ve.

Ne nuk konsiderojmë se mangësit e bëra në draft llogaritë (pasqyrat) tregojnë dobësi të konsiderueshme në kontabilitet ose kontrollit.

Marrë parasysh atë më lart - Deklarata e bërë nga ZKA dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të janë dorëzuar në Qeveri mund të konsiderohen të plota, në përjashtim të informatave lidhur me pasurinë në posedim të ZPRK-së.

Rekomandimet

1. Çështja - Procesi i prodhimit të llogarive - Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Pasuritë kapitale dhe jokapitale janë paraqitur në PVF sipas vlerës së tyre të blerjes dhe jo sipas vlerës së tyre neto. Në aneksin e bashkangjitur në PVF pasuria është paraqitur sipas vlerës së blerjes dhe vlerës neto, mirëpo në shpalosjet e bëra në PVF pasuria është prezantuar sipas vlerës blerëse të saj.

Rreziku Kjo rrit rrezikun që Menaxhmenti dhe palët tjera të interesit të marrin vendime duke u bazuar në raporte jo të plota për pasurinë.

Rekomandimi 1 Menaxhmenti duhet të sigurojë që gjatë përpilimit të llogarive për 2013, pasuritë në posedim janë paraqitur në PVF sipas vlerës neto tyre.

2.3 Opinioni i Auditimit

Pasqyrat vjetore financiare në të gjitha aspektet materiale paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë*.

Si *Theksim i çështjes*, ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin që informacionet e shpalosura në PVF në lidhje me vlerën e pasurive janë të pasakta dhe jo të plota. Kjo nuk ka ndikim në ndonjërin prej 2 Pasqyrave vjetore financiare (Pranimet dhe Pagesat e Parasë së Gatshme dhe Krahasimin e Buxhetit dhe Shumat Aktuale), sipas SNISA (**SNISA 400 Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes**).

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Gjatë auditimit ne kemi testuar nivelin e adresimit të rekomandimeve të vitit paraprak duke u bazuar në planin e veprimeve të pranuar nga ZPRK. Menaxhmenti ka vepruar sipas planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve tona të vitit paraprak, mirëpo mbetet sfidë edhe më tutje implementimi i tyre i plotë.

Përshkrimi

Në raportin e auditimit për vitin e kaluar ne kemi dhënë rekomandime lidhur me përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrolleve. Menaxhmenti i ZPRK-së ka përgatitur një Plan Veprimi (PV) për adresimin e tyre.

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2011 për ZPRK-së ka rezultuar me 7 (shtatë) rekomandime kryesore.

Në fund të auditimit tonë për 2012, ne kemi vlerësuar nivelin e adresimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe kemi verifikuar se: dy (2) rekomandime janë adresuar plotësisht, katër (4) janë adresuar pjesërisht, dhe një (1) nuk ishte adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Rekomandimi

2. Çështja - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioriteti - i rëndësishëm

- E gjetura** Nga 7 (shtatë) rekomandimet e dhëna për vitin 2011, vetëm rekomandimet lidhur me pagesën e pensionit familjar për familjen e ish presidentit dhe regjistrimit dhe llogaritjes së shpenzimeve për udhëtime zyrtare ishin adresuar plotësisht. Ndërsa, katër (4) rekomandimet tjera ishinë në proces të adresimit. Rekomandimi lidhur me menaxhimin e pasurive nuk ishte adresuar ende.
- Rreziku** Implementimi i vetëm dy (2) nga shtatë (7) rekomandimet e dhëna tregon faktin që ZPRK nuk e ka funksionalizuar plotësishtë planin e veprimit. Kjo rrit rrezikun që mangësit e njëjta të përsëriten vazhdimisht.
- Rekomandimi 2** Menaxhmenti duhet të rishikoj planin e veprimit për të siguruar që stafi llogaridhënës ka kuptuar përgjegjësit dhe detyrat e deleguara si dhe afatet kohore të përcaktuara në atë plan. Më tutje, ZPRK duhet të identifikojë çështjet të cilat janë të një rëndësie të madhe me theks të veçant ato me mangësi sistematike.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Kjo mund, për shembull, të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrolleve operative të nivelit më të ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive.

Aty ku është e përshtatshme, ne gjithashtu e konsiderojnë vetë-vlerësimin e ZPRK-së të ndërmarrë në kuadër të Menaxhimit Financiar /Kontrollit (MF/K) është një hap drejt përmirësimit të vazhdueshëm në mënyrë që kontrollet funksionojnë në mënyrë efektive.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Konkluzioni i përgjithshëm

Buxheti i ZPRK-së për vitin 2012 është shpenzuar për qëllimet e planifikuara, me përjashtim të planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve tek kategoria për investime kapitale.

Realizim i ulët vërehet edhe tek kategoria e shërbimeve komunale, ku shpenzimet e realizuara në krahasim me buxhetin e planifikuar ishin në masën prej 21%. Kjo mund të ndikoj që një pjesë e madhe e mjeteve të mbesin të pashfrytëzuara dhe të barten si suficit buxhetor.

Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për ZPRK dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (ne euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Burimet e Fondeve:	2,600,365	2,600,365	1,422,994	1,230,155	1,433,140
Granti i Qeverisë-Buxheti	2,600,365	2,600,365	1,422,994	1,230,155	1,433,140

Nga të dhënat e prezentuara në tabelën e mësipërme mund të vërejmë se granti qeveritar ishte burimi i vetëm i financimit të aktiviteteve të ZPRK-së. Shkalla e shfrytëzimit të buxhetit për këtë periudhë është në nivel prej 55%, që prezanton një nivel të ulët të shpenzimit të buxhetit. Shkaqet e shfrytëzimit të buxhetit në këtë nivel ishin se shpenzimet e parashikuara për investime kapitale nuk ishin realizuar (për më shumë shih sqarimet e dhëna poshtë tabelës 2).

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (ne euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	2,600,365	2,600,365	1,422,994	1,230,155	1,433,140
Pagat dhe Mëditjet	518,365	526,965	511,192	440,474	301,448
Mallrat dhe Shërbimet	990,000	981,400	860,743	768,400	1,086,298
Komunalitë	52,000	52,000	11,061	14,447	15,856
Subvencionet dhe Transferet	40,000	40,000	39,998	6,834	29,538
Investimet Kapitale	1,000,000	1,000,000	-	-	-

Tabela 2 tregon si në vijim:

- Buxheti final i ZPRK-së në krahasim me buxhetin fillestar në total nuk ka pësuar ndryshime, me përjashtim të transferit të mjeteve në vlerë prej 8,600€ nga kategoria mallra dhe shërbime në kategorin e pagave dhe mëditjeve. Rritja në këtë kategori në vlerë prej 8,600€ ishte bërë për nevoja të pagesës së pagave dhe mëditjeve të Këshillit Konsultativ për Komunitete i cili funksionon në kuadër të ZPRK-së.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

-
- Buxheti i ZPRK-së nëpër kategori është shpenzuar në nivel të knaqshëm në përjashtim të kategorisë për shërbime komunale dhe investime kapitale. Shpenzimet e parashikuara për **investime kapitale** janë mjete të cilat i ndahen ZPRK-së çdo vit për ndërtimin e projektit të paraparë për rezidencën presidenciale të ashtuquajtur “shtëpia e bardhë”. Sipas pohimeve të zyrtarëve në ZPRK, shkak për mos realizimin e këtij projekti është, se shumica e ndarë për këtë projekt nuk është e mjaftueshme për realizimin e tij dhe për këtë arsye bartet nga viti në vit. Po ashtu, realizimi i ulët i buxhetit vërehet edhe tek kategoria e shërbimeve komunale, ku shpenzimet e realizuara në krahasim me buxhetin e planifikuar ishin në masen prej 21%.

Rekomandimi

3. Çështja - Realizimi i Buxhetit - Prioriteti-i rëndësishëm

E gjetura Shpenzimet e kategoris investime kapitale është fusha kryesore në të cilën realizimi i buxhetit është i dobët dhe kjo fushë e shpenzimeve nuk është marrë në konsideratë nga ZPRK gjatë planifikimit të buxhetit. Në nivel të ulët të shfrytëzimit të buxhetit ka ndikuar edhe mos shfrytëzimi i buxhetit për shërbimet komunale.

Rreziku Mos shfrytëzimi i buxhetit të planifikuar ul efektivitetin e veprimtarisë së ZPRK-se veçanërisht në fushat e investimeve kapitale dhe shërbimeve komunale. Kjo mund të ndikoj që objektivat e përcaktuara të ZPRK-së të mos arrihen.

Rekomandimi 3 Menaxhmenti duhet të sigurojë përgatitjen e buxhetit 2013 duke u bazuar në një vlerësim të qëndrueshëm të nevojave, në mënyrë që shfrytëzimi i buxhetit të jetë në pajtim me planifikimin.

4.3 Kerkesat e raportimit

Konkluzioni i përgjithshëm

Si rezultat i auditimit të kryer ne mund të konkludojm se ZPRK ka përmbushur kërkesat për raportim të jashtëm.

Menaxhmenti i ZPRK-së ka marr në konsideratë këshillën tonë në fazën e përkohshme dhe si rrjedhojë ka kryer një proces të pjesërishtë të vetëvlerësimit, i cili do të zhvillohet më tutje në të ardhmen me mbështetje nga Ministria e Financave. Procesi fillestar i vetëvlerësimit është një zhvillim pozitiv.

Përshkrim

ZPRK ka përmbushur kërkesat vijuese për raportim të jashtëm me cilësinë e duhur dhe duke respektuar afatet kohore , përveç raportit për vetëvlerësim dhe kontrole të brendshme.

- Kërkesa Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Draft Plani dhe plani perfundimtar i prokurimit me kohë;
- Raportet mbi borxhet e dorëzuar në MF; dhe
- Plani i Veprimit për implementimin e rekomandimeve.

Siq shihet, ZPRK ka përmbushur kërkesat për raportim të jashtëm me cilësinë e duhur dhe duke respektuar afatet kohore, përveç kompletimit të raportit për vetëvlerësim dhe kontrole të brendshme.

Rekomandimet

4. Çështja - Raportet mbi kontrollet e brendshme, përfshirë raportin e vetëvlerësimit - Prioriteti - i rëndësishëm

- E gjetura** Gjatë procesit të auditimit, , na është prezentuar një raport i bërë nga ana ZPRK-së lidhur me vetëvlerësimin e punës, vetëm nga një sektor por jo edhe vetëvlerësimi i bërë edhe nga sektorët tjerë, si kërkesë e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
- Rreziku** Vetëvlerësimi është proces i cili do të ndihmonte menaxhmentin e ZPRK-së në përcaktimin e rrezikut për efektivitetin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për të gjithë sektorët në kuadër të saj, si mjet përkrahës në arritjen e objektivave të punës.
- Rekomandimi 4** Të ndërmer hapat e duhur që të siguroj përgaditjen e raporteve për vetëvlerësim dhe kontrole të brendshme për të gjithë sektorët e ZPRK-së.

4.4 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm mbi shpenzimet

Rezultatet e testeve tona kanë treguar që stafi përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit nuk ka arritur që të krijoj uniformitet dhe konsistencë duke përdorur praktikën më të mirë për të arritur vlerën për parandë. Planifikimi jo i mirë i prokurimit ka rezultuar me prokurime emergjente dhe në ndarjen e kërkesave për prokurim të cilat janë kryesisht të njëjta ose të ndërlidhura.

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Zyrtari i prokurimit kishte hartuar planin e prokurimit për vitin 2012 dhe të njëjtin e ka dërguar në APP. ZPRK për vitin 2012 kishte realizuar prokurime që kanë rezultuar me nënshkrimin e 74 kontratave.

Ne kemi rishikuar planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara, ku në bazë të planit tonë të auditimit ne kemi bërë një përzgjedhje prej 9 mostrave të procedurave të prokurimit dhe 55 në listën e pagesave në vlerë financiare 348,459€ për të kryer testimet e nevojshme.

Rekomandimi

5. Çështja - Mos harmonizim në mes planit të prokurimit dhe buxhetit - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura	Ne kemi rishikuar planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara, ku kemi vërejtur se vlera e parashikuar e kontratave të prokurimit ishte dukshëm më e madhe sesa buxheti i planifikuar. Diferenca më e madhe ekziston tek vlera e planifikuar për investime kapitale në raport me buxhetin për këtë kategori.
Rreziku	Mos harmonizimi i planit të prokurimit me buxhetin, rrit rrezikun që aktivitetet e planifikuara të prokurimit të dështojnë si dhe rrezikon shfrytëzimin e buxhetit për qëllime të paplanifikuara.
Rekomandimi 5	Menaxhmenti duhet të sigurojë që plani i prokurimit është përgatiturë duke pasur parasysh buxhetin e aprovuar për vitin përkatës.

6. Çështja - Kontrata të shumta për artikujt të njëjtë – prioritet tjetër

E gjetura Ne kemi vërtetur se planifikimi jo i mirë i prokurimit ka rezultuar me prokurime emergjente, dhe në ndarjen e kërkesave për prokurim, të cilat janë kryesisht të njëjta ose të ndërlidhura siq janë rastet në vijim:

Për “Furnizim me fasiklla me llogo” janë nënshkruar katër kontrata me vlerë minimale, ku në tri raste fitues ka qenë i njëjti operator ekonomik.

Për “Furnizim me paisje të TI” janë nënshkruar tri kontrata. Po ashtu raste të tilla kemi hasur edhe për furnizime tjera.

Rreziku Realizimi i prokurimeve emergjente dhe ndarja e kërkesave për furnizime të njëjta rrit rrezikun që të mos arrihet vlera për para.

Rekomandimi 6 Menaxhmenti duhet të sigurojë që është evituar ndarja e kërkesave të prokurimit që janë kryesisht të njëjta ose të ndërlidhura dhe të mbledhë kërkesat, kur është e mundshme, për të fituar vlerën për parandë dhe për të reduktuar kostot e prokurimit.

7. Çështja - Pagesa për Paisje kapitale nga kategoria mallra dhe shërbime- prioritet –i rëndësishëm

E gjetura LMFPF përmban mundësin për t’i transferuar ndarjet buxhetore nga një kategori ekonomike e një programi në një kategori tjetër ekonomike.

Ne kemi vërtetur se gjatë vitit 2012, ZPRK-ja nga mjetet e planifikuara për mallra dhe shërbime kishte blerë 10 (dhjetë) vegla për medalje në vlerë prej 35,640€, dy llaptopa me vlerë prej 2,540€, një klimë në vlerë 1,250€ si dhe një binë ceremoniale prej alumini në vlerë prej 3,900€. Këto pajisje është dashur të blihen nga kategoria e investimeve kapitale. Blerja e këtyre pajisje nga mjetet e parapara për mallrat dhe shërbime është bërë në mungesë të mjeteve nga Investimet kapitale.

Rreziku ZPRK nuk ka shfrytëzuar mundësin ligjore për transfer të mjeteve nga kategoria mallra dhe shërbime në kategorin investime kapitale. Kasifikimi, procesimi dhe regjistrimi i shpenzimeve në kundërshtim me planin kontabël (rregullat e thesarit), paraqet pasqyrim të pasaktë të shpenzimit.

Rekomandimi 7 Menaxhmenti duhet të sigurojë që të gjitha shpenzimet bëhen në përputhje me ndarjet buxhetore siq kërkohet me LMFPF.

8. Çështja - Regjistrimi në kodin ekonomik të gabuar – prioritet tjetër

- E gjetura** Ne kemi vërejtur se shpenzimet nuk janë klasifikuar në kodin ekonomik adekuat siq janë rastet në vijim:
- Tek kontrata për furnizim me material për zyre, pagesa në vlerë prej 1,653€ është regjistruar si shërbim kontraktues në kodin ekonomik 13460, ndërsa është dashur të regjistrohet në kodin 13610.
- Po ashtu në dy raste pagesat për udhëtime zyrtare janë regjistruar në tërsi si shpenzime të udhëtimit edhe pse në planin kontabel ka kode adekuate për mëditje të udhëtimit zyrtar jashtë vendit, akomodim dhe shpenzime tjera.
- Rreziku** Regjistrimi i shpenzimeve në kode joadekuate ndikon në raportimin jo të drejtë të shpenzimeve.
- Rekomandimi 8** Menaxhmenti duhet të sigurojë që të gjitha shpenzimet regjistrohen në kodet ekonomike përkatëse.

4.4.2 Shpenzimet tjera

Përshkrim

Prezentimin dhe shpalosjen e shpenzimeve tjera në PVF, ZPRK i ka paraqitur drejt dhe në përputhshmëri me kërkesat e raportimit financiar.

Gjatë vitit 2012, ZPRK për qëllime të udhëtimit zyrtarë kishte shpenzuar 270,378€ apo 31.4% nga mjetet e shpenzuara në kategorinë mallra dhe shërbime.

ZPRK nuk ka arritur t'i zbatoj plotësisht kërkesat ligjore lidhur me respektimin e afateve për mbylljen e avanseve për shpenzimet e udhëtimit zyrtarë.

Rekomandimi

9. Çështja - Mos mbyllja me kohë e avanseve për udhëtime zyrtare - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Ne kemi vërejturë që gjashtë (6) avanse për udhëtime zyrtare në vlerë prej 21,097€ nuk janë mbyllur në pajtim me kërkesat e Udhëzimit administrativ të MAP nr. 2004/07 për udhëtime zyrtare dhe Udhëzimit të Thesarit nr. 02. Sipas udhëzimeve në fuqi të gjitha avanset duhet të mbylleten 15 ditë pas kthimit nga udhëtimi zyrtare.

Rreziku Mos rerspektimi i procedurave rreth avanseve ka ekspozuar ZPRK-në të nënshtrohet rrezikut për të zbatuar plotësishtë kërkesat ligjore lidhur me respektimin e afateve kohore për mbylljen e avanseve për shpenzimet e udhëtimeve zyrtare.

Rekomandimi 9 Menaxhmenti duhet t'i shqyrtoj rastet e tilla në mënyrë që të identifikoj arsytet dhe personat përgjegjës për mos arsyetimin e avanseve dhe të merr masa konkrete për mbylljen e tyre duke respektuar afatin kohor.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Gjatë procesit të auditimit të kategorisë Paga dhe Mëditje kemi rishikuar se buxheti nga kjo kategori për vitin 2012 ishte 526,965€, ndërsa janë shpenzuar 511,192€, apo 97% të buxhetit të planifikuar për këtë kategori. ZPRK në fillim të vitit i kishte të aprovuar me buxhet 82+4(86) pozita, ndërsa në fund të vitit i kishte 58 të punësuar.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operohen në nivel intern nga ZPRK-së kanë të bëjnë me:

- mbajtjen dhe azhurnimin e rregullt nga zyra e personelit të dosjeve të të punësuarve;
- sektori i financave është njoftuar rregullisht dhe me kohë lidhur me ndryshimet në lidhje me pagat dhe mëditjet ; si dhe
- për të gjitha ndryshimet e ndodhura janë lëshuar vendimet, nga Sekretari apo Drejtori i Administratës, në bazë të të cilëve janë bërë kompensimet për shtesat dhe punët apo angazhimet e kryera jashtë orarit të rregullt të punës dhe pagesa e tyre është bërë përmes sistemit të pagave.

Rekomandimet

10. Çështja - Kompensimet për angazhimet jashtë orarit – Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Gjatë auditimit ne vërejtëm se nuk kishte informata lidhur me arsyen, qëllimin dhe llojin e punëve të kryera jashtë orarit, me përjashtim të specifikacionit lidhur me datat e angazhimit dhe orët e kaluara jashtë orarit të rregullt të punës. Sipas zyrtarëve të ZPRK-së kjo ka ndodhur për shkak të natyrës dhe specifikave të angazhimit të stafit në mbështetje të aktiviteteve të Presidentes.

Rreziku Mos përshkrimi i arsyes së angazhimit të stafit dhe llojit të punëve të kryera jashtë orarit të punës mund të shpije në rrezikun që pagesat janë kryer, por nuk është ndërmarrë ndonjë punë. Kjo krijon paqartësi lidhur me kompensimet e bëra.

Rekomandimi 10 Menaxhmenti duhet të siguroj që para çdo angazhimi dhe kompensimi për punë jashtë orarit janë definuar qartë personat, arsyet, qëllimi dhe lloji i punëve që kanë nevojë të kryhen.

4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Sipas buxhetit, ZPRK gjatë vitit kishte ndarë subvencione për entitetet publike në shumë prej 16,953€, ndërsa subvencione për entitete jo pulike ishin në shumë prej 23,045€.

Testet tona rezultuan se subvencionet janë shpenzuara në bazë të vendimeve të nxjerra paraprakisht dhe të aprovuara nga personat e autorizuar. Pagesat ishin aprovuar dhe certifikuar nga personat kompetent dhe pagesat ishin bërë në llogarinë e përfituesit.

Testimet e shpenzimeve të subvencioneve nuk kanë rezultuar me ndonjë parregullsi. Pagesat e subvencioneve janë kryer në harmoni me procedurat e kërkuara ligjore.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5 Pasuritë

Konkluzioni i përgjithshëm mbi pasuritë

Mund të konkludojmë se ZPRK, me gjithë përpjekjet e bëra, nuk ka arritur akoma që të emëroj zyrtarin e pasurisë, që krijon siguri të menaxhojë pasurinë në pajtim të plotë me kërkesat ligjore. Si rezultat i kësaj ZPRK nuk ka arritur të ketë një regjistër kontabël (SIMFK) të plotë dhe të saktë .

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit, mënyra e mbajtjes së evidencës dhe menaxhimi i pasurive jo financiare në ZPRK është në pajtim me kërkesat e UA nr.21/2009 mbi menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive qeveritare.

Vlera e pasurive kapitale (mbi 1,000€) të ZPRK-së e paraqitur në PVF ishte 3,560,691€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1000€) ishte 291,596€. Pasuritë janë paraqitur sipas vlerës blerëse (kostos historike) të tyre. Shënimet janë marrë nga regjistri i brendshëm i pasurisë të cilin e posedon ZPRK-ja ngase regjistri kontabël (SIMFK) nuk ishte i azhurnuar.

ZPRK -ja në përputhje me UA nr 21/2009 në fund të vitit 2012, kishte formuar komisionet për inventarizim dhe vlerësim të pasurive, këto komisione kishin përgatitur raportet siç kërkohet me këtë UA.

Rekomandimi

11. Çështja - Regjistrimi i pasurisë në regjistrin kontabël (SIMFK) - Prioritet i rëndësishëm

E gjetura ZPRK-ja me gjithë përpjekjet e bëra ende nuk ka arritur të ketë një regjistër kontabël (SIMFK) të plotë dhe të saktë . Në mungesë të një zyrtari të pasurive kjo detyrë i është caktuar një zyrtari tjetër, i cili nuk kishte ndjekur trajnimet e nevojshme, andaj menaxhimi i pasurive është bërë nga një zyrtar tjetër i TI-së.

Rreziku Mangësitë e theksuara rreth menaxhimit të pasurive pamundësojnë gjenerimin e raporteve gjithpërfshirëse si dhe ofrojnë mundësi për keq menaxhimin , përdorimin për qëllime tjera apo edhe humbjen tyre.

Rekomandimi 11 Të forcohen kontrollet rreth regjistrimit të transaksioneve në regjistrat kontabël, menaxhimi i tyre të bëhet nga zyrtarë të autorizuar, kompetent dhe të trajnuar.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Konkluzion i përgjithshëm mbi auditimin e brendshëm

Puna e Auditimit të Brendshëm në vitin 2012 mori parasysh kryesisht vetëm aktivitetet e vitit 2010 dhe 2011, dhe vetëm në një rast kishte trajtuar aktivitetet për vitin 2012. Kështu që aktiviteti i tij vetëm pjesërisht e ka mbështetur menaxhmentin në vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të përgjithshme të kontrollit të brendshëm.

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu ndaras. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit. Përveç kësaj, ne i kemi shqyrtuar veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit.

ZPRK e ka të themeluar NJAB, e cila aktivitetin e saj e kryen vetëm me një auditor.

Drejtori i NJAB-së kishte përgatitur planin vjetor të auditimit për vitin 2012, i cili është aprovuar nga menaxhmenti i ZPRK-së. NJAB ka planifikuar që të kryej auditimin për fushën e prokurimit- procedurat e prokurimit, buxheti- avanset, buxheti dhe shpenzimet buxhetore dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm. Për periudhën e vitit 2012 kishte arritur të kryej 3 (tri) auditime.

NJAB kishte kryer auditime në këto fusha: auditimin e procedurave të çertifikimit të lëndëve për avanset e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit që ka mbuluar periudhën e vitit 2011, auditimin për menaxhimin e veturave të ZPRK-së që kishte mbuluar periudhën e vitit 2010 dhe 2011 si dhe auditimin e procedurave të prokurimit për vitin 2012.

Këto auditime i kanë trajtuar çështjet përkatëse dhe kanë dhënë rekomandimet adekuate.

ZPRK e ka të formuar Komitetin e auditimit të përberë prej tre anëtarëve. Komiteti i auditimit gjatë këtij viti ka mbajtur 4 (katër) takime të rregullta. Në takimet e mbajtura është diskutuar implementimi i rekomandimeve të dhëna nga ZAP-i dhe NJAB.

Rekomandimet

12. Çështja - Fokusimi i auditimit të brendshëm në aktivitetet aktuale - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Siç mund të vërehet fushëveprimi i auditimit të brendshëm kryesisht ka mbuluar aktivitetet e vitit 2010 e 2011 dhe vetëm në një rast kishte përfshirë aktivitetet që lidhen me vitin 2012.

Rreziku Mos auditimi i aktiviteteve në proces dhe atyre aktuale nga NJAB ka rezultuar që Menaxhmenti i ZPRK-së mos të ketë informacione lidhur me çështjet aktuale mbi efektivitetin e Kontrolleve të Brendshme gjatë vitit 2012.

Rekomandimi 12 Menaxhmenti duhet të siguroj se NJAB fokusohet më shumë në vitin aktual, ku menaxhmenti mund të informohet më në hollësi për aktivitetet që janë në proces dhe të ndërmerr masa për përmirësim.

6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni jonë i përgjithshëm e pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe të Sistemit të Auditimit të Brendshëm.

Në shumicën e fushave ZPRK ka dizajnuar sisteme të kontrollit të brendshëm të cilat sigurojnë bazë për të siguruar përdorim efektiv dhe efikas të parasë publike dhe/ose dhënien e informatave të cilësisë së mirë, të cilat mbështesin vendimmarrjet e menaxhmentit.

Përkundër kësaj ne kemi identifikuar mangësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në fushat e paraqitura në kapitujt me lartë. Mangësitë e vërejtura mund të rezultojnë me mos arritjen e objektivave të përcaktuara.

Si rezultat i auditimit të kryer ne kemi konstatuar ZPRK ka përgatitur PVF-të e saj në përputhje me kornizën e raportimit të jashtëm, mirepo informatat në lidhje me pasurinë në posedim të ZPRK-së janë shpalosur në PVF sipas vlerës së tyre blerëse e jo sipas vlerës së tyre neto.

Menaxhmenti i ZPRK-së ka përgatitur një Plan Veprimi (PV) për adresimin e rekomandimeve të mëhershme, mirepo mbetet sfidë edhe më tutje implementimi i tyre i plotë.

Sistemi i informacionit dhe komunikimit nuk ka funksionuar në nivelin e duhur ndërmjet zyrtarit të prokurimit dhe zyrtarëve përgjegjës për buxhet dhe departamenteve tjera për të diskutuar kërkesat e tyre për prokurim dhe buxhetin në disponueshmëri për vitin 2012. Në mungesë të këtij komunikimi dhe një analize paraprake, ZPRK nuk ka arritur të siguroj një plan të mirëfillt të prokurimit.

ZPRK-ja duhet të shtoj përpjekjet për ti zbatuar rregullat e MF/K-së në të gjitha strukturat, programet, operacionet dhe proceset e menaxhuara duke respektuar parimet e ligjshmërisë dhe menaxhimit të mirëfilltë financiar të cilat ofrojnë siguri të arsyeshme se rreziqet për organizatën, menaxhohen në mënyrë efektive.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifikë të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionit i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriktionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionit i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhena	Rekomandimet plotesisht te adresuara	Rekomandimet pjeserisht te adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1. Planifikimi dhe Ekzekutimi i buxhetit	Në bashkëpunim me Presidentin dhe organet tjera relevante të gjindet një zgjidhje në lidhje me objektin e paraparë të Presidencës		Janë ndërmarrë hapa sa i përket adresimit të rekomandimeve tona nga menaxhmenti i ZPRK, por ende nuk ka vendim për fillimin e punëve për ndertimin e objektit	
2. Pasqyrat Financiare	Mangësitë në PVF lidhur me raportimin e pasurive kapitale dhe atyre jo kapitale të analizohen dhe se informatat në Pasqyrat Nëntëmujore Financiare të ardhshme të jenë të sakta		ZPRK ka azhurnuar regjistrin e pesuris. Pasuritë tani janë regjistruar në vlerën e tyre neto, por prezantimi në PVF është bërë sipas vlerës së tyre blerese	
3. Kompensimet (Pagat dhe Meditjet)	Pagesa e pensionit familjar për familjen e ish presidentit të klasifikohet si Subvencion	Po		
4. Blerjet përmes prokurimit	Planifikimi i prokurimit të bëhet me harmoni me nevojat reale të institucionit, si dhe mundësitë buxhetore; Procedurat e prokurimit të realizohen në përputhje të plotë me kërkesat ligjore;		Janë ndërmarrë masa lidhur me vendosjen e kontrolleve gjatë procesit të prokurimit, por mbetet ende për të vendosur kontrolle shtesë lidhur me respektimin e procedurave të prokurimit.	

	Një udhëzues i brendshëm për prokurimin të nxirret, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së stafit në lidhje me kërkesat e reja ligjore.			
5.Blerjet tjera	<p>Të shtohen kontrollet në sektorin e pagesave me qëllim të klasifikimit, regjistrimit dhe llogaritjes së shpenzimeve në pajtim me kërkesat ligjore;</p> <p>Të shqyrtohet mundësia e rregullimit të çështjes së shpenzimeve për udhëtime zyrtare me ndonjë udhëzim apo rregullore të brendshme; dhe</p> <p>Të gjitha furnizimet që mund të planifikohen të bëhen përmes procedurave të prokurimit dhe paratë e imëta të shpenzohen vetëm për qëllimet e lejuara konform dispozitave ligjore</p>	Po		
6.Menaxhimi i pasurise	<p>Të vazhdojë përpjekjet në drejtim të korrigjimit të regjistri kontabël deri në finalizimin e të gjitha korrigjimeve të nevojshme; dhe</p> <p>Ka siguruar trajnime të mjaftueshme për zyrtarin e pasurive</p>			Nuk është marr ndonje mase

7. Auditimi i brendshem	<p>Janë adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna nga NjAB, në mënyrë që të evitohen mangësitë e evidentuara;</p> <p>NjAB të fokusohet më tepër në fushat ku janë identifikuar ngecje në funksionimin e kontrolleve të brendshme;</p> <p>Të shtohen përpjekjet në drejtim të përmbushjes së planit vjetor të auditimit.</p>		<p>Menaxhmenti permes komitetit te auditimit ka trajtuar rekomandimet e dhena si dhe auditimi i brendeshem është fokusuar në fushat me rrezik të lartë siq eshte fusha e prokurimit, por NJAB-i duhet të fokusohet me shume në auditimet e aktiviteteve ne proces.</p>	
-------------------------	---	--	--	--